

RELACION TEKNIK KONSTRUKTIV

1. PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM I OBJEKTIT

Emertimi i objektit:	RIKONSTRUKSION I OBJEKTIT EGZISTUES DHE SHTESA ANESORE 3 KAT + 1 KAT PALESTER I SHKOLLES “Jorgji DILO”
Porosites:	Bashkia Elbasan
Vendndodhja:	Lagjja “28 Nentori”, Rruga “Qemal STAFA” Elbasan
Destinacioni :	GODINE SHERBIMI (SHKOLLE)
Konstruktor:	Ing. Kons. RESHIT BEDHIA

2. KODET DHE REFERENCAT

- 
- `` Kusht Teknik Projektimi per Ndertimet Antisizmike KTP-N.2-89 ``
(AKADEMIA E SHKENCAVE, Qendra Sizmologjike)
 - ``Kushte teknike te projektimit``, Libri II, (KTP-6,7,8,9,1978)
 - ``Eurocode 2 : Design of Concrete Structures FINAL DRAFT prEN 1992-1-2``, December 2003
 - ``Eurocode 8 : Design of Structures for Earthquake Resistance FINAL DRAFT prEN 1998-1``, December 2003).
 - ``Principles of Foundation Engineering``, Pws-Kent Publishing Company, Boston 1984 (Braja M Das)
 - ``Studim mbi Kushtet Gjeologo Inxhinierike te Sheshit te Ndertimit per Objektin me ``Bodrum + 10 Kate Banese `` Lagjja ``Luigj GURAKUQI`` Rruga “Qemal STAFA” me autor Ingxinier Gjeolog Aqif Mjeshtri, Lic. Gj. 0150
 - Studimi sizmik i kryer nga Studio “GeoSeis –IT Consulting” me perfaqesues Ing Llambro DUNI Lic.N6399/1
 - ``Foundation Analysis and Design``, McGraw-Hill1991 (Josepf E. Bowles)
 - ``Foundation Vibration Analysis Using Simple Physical Models`` PTR Prentice Hall 1994 (John P. Wolf)
 - ``Soil-Structure Interaction Foundation Vibrations ``, 2002 (Gunther Schmidt, Jean-Georges Sieffert)
 - ``Geotechnical Earthquake Engineering`` Prentice Hall 1996 (Steven L. Kramer)
 - ``Reinforced Concrete Structures``, John Wiley & Sons. 1975 (R. Park and T.Paulay)
 - ``Seismic Design of Reinforced Concrete and Masonry Buildings `` John Wiley & Sons 1992 (T. Paulay & M.J.N. Priestley)
 - ``Earthquake-Resistant Concrete Structures``, E&FN SPON (George G. Penelis, Andreas J. Kappos).
 - ``Reinforced Concrete Mechanics and Design``, Third Edition, Prentice Hall, (James G. MacGregor).

3. MATERIALET

- Klasa e betonit te parashikuar ne projekt per pllaken e themelit eshte C20/25.
 - Klasa e betonit te parashikuar ne projekt per elementet vertikale, kolonat dhe strukturat horizontale, trare dhe soleta eshte C20/25
 - Celiku i perdorur ne objekt eshte importi S 500 me kufi rrjedhshmerie $\sigma_{rrj} = 500 \text{ MPa}$. Kjo klase hekuri eshte parashikuar per te gjitha llojet e armaturave te perdorura ne objekt.
- Rezistencat llogaritese (te projektimit) per betonin dhe celikun jane marre nga reduktimi i rezistencave karakteristike sipas klasses se betonit (apo celikut) te perdorur me faktorin e sigurise perkates si me poshte:


Per celikun: $f_{yd} = f_{yk}/\gamma_s$
 $f_{ywd} = f_{ywk}/\gamma_s$

Per betonin: $f_{cd} = f_{ck}/\gamma_c$
 $f_{cwd} = f_{cwk}/\gamma_c$

Materialet e perdorura paraqiten ne menyre tabelare si me poshte :

MATERIALS			
Column Concrete Type:	C25/30	Column Stirrup Steel Type:	S500
Slab Concrete Type:	C25/30	Column Bar Steel Type:	S500:
Beam Concrete Type:	C25/30	Slab Bar Steel Type:	S500:
Shear Walls Concrete Type:	C25/30	Shear Bar Steel Type:	S500:
Rough Foundation Concrete Type:	C25/30	Beam Bar Steel Type:	S500:
Inactive Walls Concrete Type:	C25/30	Foundation Bar Steel Type:	S500:
Slab Stirrup Steel Type (Zoellner Slabs):	S500	Beam Stirrup Steel Type:	S500

**Procurement
Albania**
Vlerat e Rezistencave per Beton C25/30 dhe celik S500



4. ANALIZA DHE LLOGARITJA KOMPJUTERIKE

Analiza statike dhe dinamike per te percaktuar reagimin e struktures ndaj tipeve te ndryshme te ngarkimit te struktures eshte kryer me programin **P-suite 8.02 dhe Sap12**. Modelimi i struktures ne teresi dhe i cdo elementi behet mbi bazen e metodikes se elementeve te fundem (Finite Element Metode- FEM) e cila eshte nje metode e perafert dhe praktike duke gjetur perdomim te gjere sot ne kushtet e epersise qe krijon perdomimi i programeve kompjuterike.

Analiza dinamike ka ne bazen e saj analizen modale me **metoden e spektrit te reagimit**. Ngarkesat dinamike, (sizmike) te llogaritura pranohen si ngarkesa ekuivalente statike dhe ushtrohen ne vendin e masave te perqendruara. Si baze per metoden e llogaritjeve dinamike me metoden e spektrit te reagimit sherben **analiza e vlerave te veta dhe e vektorave te vete**. Me ane te kesaj metode percaktohen format e lekundjeve vetjake dhe frekuencat e lekundjeve te lira. **Vlerat dhe vektorat e vete** jepin pa dyshim nje pasqyre te qarte dhe te pote per percaktimin e sjelljes se struktures nen veprimin e ngarkesave dinamike. Programi **P-suite 8.04 dhe Sap12** automatikisht kerkon modet me frekuencia rrethore me te uleta (perioda me te larta) –shiko piken 8- si me kontribuese ne thithjen e ngarkesave sizmike nga struktura. Numri maksimal i modeve te kerkuara nga programi eshte kushtezuar nga vete konstruktori ne $n=9$ mode, nderkohe qe masat e kateve te ketij objekti jane konsideruar me tre shkalle lirie, ne te cilat 2 rrotulluese *dhe nje translative sipas planit te vete soletes*. Frekuencia ciklike f (cikle/sec), frekuencia rrethore ω (rad/sec) dhe perioda T (sec) jane lidhur midis tyre nepermjet relacioneve: $T=1/f$ dhe $f=\omega/2\pi$. Si rezultat i analizes merren zhvendosjet, forcat e brendshme (M , Q , N) dhe sforcimet σ ne cdo emelente te struktures. Analiza me metoden e spektrit te reagimit eshte kryer duke perdonur superpozimin modal. (Sipas Wilson & Button 1982).

5. NGARKESAT LLOGARITESE NE PROJEKT

5.1 Ngarkesat e perhershme (*Dead Loads-DL*)

Ne ngarkesat e perhershme jane perfshire: Pesha vetjake e gjithe elementeve mbajtes te struktures beton arme (themeli, trare, kolona, pesha vetjake e soletave, shtresave te dyshemese, muret ndares vetembajtes me tulla me bira, dhe parapetet e ballkoneve, shkallevet etj). Ngarkesat e normuara qe jane marre ne considerate per strukturen e mesiperme jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

DEAD LOADS					
Concrete specific gravity:	25.00	kN/m ³	Slab coating:	1.50	kN/m ²
Steel specific weight:	78.00	kN/m ³	Room tiling:	1.50	kN/m ²
Header wall weight:	3.60	kN/m ²	Staircase tiling:	1.30	kN/m ²
Stretcher wall weight:	2.10	kN/m ²	Soil specific gravity:	18.00	kN/m ³

5.2 Ngarkesat e perkohshme (*Live Loads-LL*)

Si ngarkesa te perkohshme ne structure jane llogaritur ngarkesat e shfrytezimit te dyshemeve te dyqaneve, nderkateve te banimit, shkallevet, ballkoneve, taracave etj, te cilat ne menyre te permbledhur jane paraqitur gjithashtu ne tabelen e meposhtme :

LIVE LOADS					
Residences floors:	3.00	kN/m ²	Offices floors:	3.00	kN/m ²
Balconies floors:	5.00	kN/m ²	Staircases floors for residences:	3.00	kN/m ²
Stores floors:	4.00	kN/m ²	Staircases floors for stores:	3.00	kN/m ²

Ngarkesat e mesiperme jane nominale dhe ne varesi te kombinimit per te cilin do te kontrollohet struktura, ngarkesat e perhershme (DL) apo ato te perkohshme (LL) shumezohen me koeficientin perkates te sigurise.

5.3 Ngarkesat sizmike: (**Earthquake Loads-EL**)

Ne perputhje me studimin inxhiniero-sizmiologjik te sheshit, parametrat e marre ne llogaritje jane :

Shpejtimi i truallit (PGA)	ag = 0.24 g (8 Balle, Kategoria e 2-te)
Kategoria e Truallit	“ E Dyte “
Koeficienti i sjelljes se strukture	q=3.0
Koeficienti i rendesise	kr=1.0
Koeficienti i shuarjes	$\zeta=5\%$
Faktori i korrigjimit te shuarjes	$\eta=1$
Faktori i themeleve	$\beta=2.5$
Objekt i rregullt ne lartesi	Kr=1

SEISMIC PARAMETERS			
Earthquake Risk Zone: (PGA)	0.24	Building Importance Factor:	1.00
Seismic Behaviour Factor (q):	3.00	Foundation Factor:	1.00
Spectral period (T1):	0.10	Spectral Amplification Factor:	2.50
Spectral Period (T2):	0.40	Critical Damping Factor:	0.05
Spectral Exponent:	0.67		



Parametrat Sizmike te Objektit

6. KOMBINIMI I NGARKESAVE

Percaktimi i aftesise mbajtese te strukture (ULS) eshte kryer duke kombinuar ngarkesat vepruese ne strukture sipas kombinimeve te meposhtme:

A	1.35G + 1.50Q		
1B	1.00G + 0.30Q + 1.00Ex+eccy + 0.30Ey+eccx	1C	1.00G + 0.30Q + 1.00Ex+eccy - 0.30Ey+eccx
1D	1.00G + 0.30Q + 0.30Ex+eccy + 1.00Ey+eccx	1E	1.00G + 0.30Q - 0.30Ex+eccy + 1.00Ey+eccx
1F	1.00G + 0.30Q - 1.00Ex+eccy - 0.30Ey+eccx	1G	1.00G + 0.30Q - 1.00Ex+eccy + 0.30Ey+eccx
1H	1.00G + 0.30Q - 0.30Ex+eccy - 1.00Ey+eccx	1I	1.00G + 0.30Q + 0.30Ex+eccy - 1.00Ey+eccx
2B	1.00G + 0.30Q + 1.00Ex-eccy + 0.30Ey+eccx	2C	1.00G + 0.30Q + 1.00Ex-eccy - 0.30Ey+eccx
2D	1.00G + 0.30Q + 0.30Ex-eccy + 1.00Ey+eccx	2E	1.00G + 0.30Q - 0.30Ex-eccy + 1.00Ey+eccx
2F	1.00G + 0.30Q - 1.00Ex-eccy - 0.30Ey+eccx	2G	1.00G + 0.30Q - 1.00Ex-eccy + 0.30Ey+eccx
2H	1.00G + 0.30Q - 0.30Ex-eccy - 1.00Ey+eccx	2I	1.00G + 0.30Q + 0.30Ex-eccy - 1.00Ey+eccx
3B	1.00G + 0.30Q + 1.00Ex+eccy + 0.30Ey-eccx	3C	1.00G + 0.30Q + 1.00Ex+eccy - 0.30Ey-eccx
3D	1.00G + 0.30Q + 0.30Ex+eccy + 1.00Ey-eccx	3E	1.00G + 0.30Q - 0.30Ex+eccy + 1.00Ey-eccx
3F	1.00G + 0.30Q - 1.00Ex+eccy - 0.30Ey-eccx	3G	1.00G + 0.30Q - 1.00Ex+eccy + 0.30Ey-eccx
3H	1.00G + 0.30Q - 0.30Ex+eccy - 1.00Ey-eccx	3I	1.00G + 0.30Q + 0.30Ex+eccy - 1.00Ey-eccx
4B	1.00G + 0.30Q + 1.00Ex-eccy + 0.30Ey-eccx	4C	1.00G + 0.30Q + 1.00Ex-eccy - 0.30Ey-eccx
4D	1.00G + 0.30Q + 0.30Ex-eccy + 1.00Ey-eccx	4E	1.00G + 0.30Q - 0.30Ex-eccy + 1.00Ey-eccx
4F	1.00G + 0.30Q - 1.00Ex-eccy - 0.30Ey-eccx	4G	1.00G + 0.30Q - 1.00Ex-eccy + 0.30Ey-eccx
4H	1.00G + 0.30Q - 0.30Ex-eccy - 1.00Ey-eccx	4I	1.00G + 0.30Q + 0.30Ex-eccy - 1.00Ey-eccx

Elementet e struktures jane kontrolluar edhe ne perputhje me deformimet e lejueshme qe shkaktohen ne to nga veprimi i ngarkesave normative. Ne keto kombinime koeficientet e kombinimit te ngarkesave jane pranuar njesi.

Efekti i perdredhjes aksidentale eshte perfshire ne llogaritjen e godines duke u inkorporuar automatikisht ne nivelin e forcave sizmike. Jashtegjendersia e veprimit te forcave sizmike per cdo kat eshte pranuar 5 % e dimensionit te godines perpendikular ne drejtimin sizmik ne studim.

Ne perputhje me kategorizimin e bere ne EC8, godina e projektuar eshte e klasit II, per te cilen faktori i rendesise eshte $\gamma_f=1.0$. (Sipas KTP-N2- 89, godine e klasit te III-te me $k_r= 1.00$.)

Spostimi i nderkatit (drifti) sipas te dy drejtimeve te eksitimit te strukture kane rezultuar brenda kufijve qe percaktohen ne EC8 per strukturat, elementet jo strukturore te te cilave nuk do te jene duktile. Per keto struktura kufiri i lejuar per zhvendosjet e nderkatit rezulton ne rendin 0.00333. Nga llogaritjet, zhvendosjet maksimale te nderkateve sipas te dy drejtimeve te eksitimit kane rezultuar :

Per drejtimin terthor :	0.035
Per drejtimin gjatesor:	0.084

Spektri i sjelljes elastike per lekundjen horizontale te truallit eshte percaktuar sipas KTP-N2-89 per troje te kategorise se dinte ku koeficienti dinamik β eshte marre $0.65 \leq \beta = 0.8/T \leq 2.0$. Ne perputhje me rekomandimet e KTP N2 89, per lekundjet vertikale eshte pranuar $\beta_v = 2/3 \beta$.

Spektri i llogaritjes perftohet nga faktorizimi i spektrit te sjelljes elastike me faktoret qe marrin parasysh reagimin dinamik te struktures.

7. ANALIZA STATIKE DHE DINAMIKE

7.1 Pershkrimi i objektit dhe i struktures

Objekti eshte projektuar me 3 kate mbi toke, dhe nje palester 1 kat me lartesi 6.5M. Plani i strukturave te katit tip ka forme te rregullt. Objekti ka si destinacion sherbimin per komunitetin (shkolle).

Lartesite e kateve jane si me poshte:

Kati perdhe:	3.60 m
Kati pare:	3.25 m
Kati dyte:	3.50 m

Lartesia totale e objektit eshte 10.35 m.

Kuota e dyshemese e katit perdhe eshte 35 cm me poshte se kuota e objektit egzistues per te fituar lartesine e ambienteve te sherbimit e palestres.

Objekti eshte konceptuar dhe llogaritur me rama hapsinore duke i dhene prioritet te dy drejtimeve te objektit per garantimin e zhvendosjeve te lejuara nga veprimet e ngarkesave te jashme, kryesisht atyre sizmike.

Objekti mbeshtetet mbi themel te shirit te vazhduar mbi bazament elastik. Lartesia e themelit eshte llogaritur ne 0.50 m (50 cm) dhe gjeresi 1.20M (120 cm). Sasia e nevojshme e armatures eshte llogaritur duke modeluar dheun si susta, me koeficientet perkates te ngurtesise.

Kolonat kane forme te prerjes terthore kryesisht drejtendeshe dhe rrethore me dimensione 40 x 60 cm, 30x60 ne anen veriore te palestres 70x40/40x70 ne disa kende te nderteses. Xhuntimi i shufrave te kolonave do te behet ne nivelin e soletave te nderkatit.



Strukturat horizontale, jane monolite te mbeshtetura ne te dy drejtimet, me trashesi $t = 20$ cm. Zgjedhja e tyre ka si qellim nje shperndarje me te mire te ngarkesave qe veprojne mbi te, neper traret e objektit dhe per te siguruar me mire rolin e tyre si nje diafragme horizontale.

Traret e mbuleses jane zgjedhur te thelle me dimensione $b \times h = 30 \times 60$ cm, 50x40 cm ne traret qe jane brenda ambienteve.

Ne llogaritjen e trareve jane vendosur ngarkesat *trapezoidale* ose *trekendore* qe vijne nga soletat (si ne skemen e meposhtme) si dhe ngarkesa e njetrajteshme qe vijne nga muret.

Muratura e tulles ne objekt eshte parashikuar me trashesi 12 dhe 20 dhe 25 cm perimetralet cm e realizuar me brima horizontale (tulla te lehtesuara). Ne skemen llogaritese, ngarkesa e muratures eshte pranuar e shperndare uniformisht ne soleta me intensitet variabel nga 100 daN/m² ne 300 daN/m² sipas ambienteve. Kjo lejon mundesine e vendosjes se saj ne cdo vend te soletes.



Menyra e shperndarjes se ngarkesave nga soletat neper trare



Bashkia „Elbasan“

Rikonstruksioni i shkoles „Jorgji DILO“


Plani i themelevë (Tip themel i vazhduar ne Bazament Elastik)- (Foundation Formwork)




Bashkia „Elbasan“

Rikonstruksioni i shkoles „Jorgji DILO“




Plani i Strukturave ne Kuoten +6.50 m





open
Procurement
Albania



Plani i Strukturave te catise me konstruksion metalik i palestres



Plani i Strukturave mbuleses verandes me konstruksion metalik



Struktura e strehes mbeshtetet mbi kolonat metalike dhe ne anen tjeter mbeshtetet ne murin egzistues te shkolles ku detaji i mberthimit me brezin e murit jepet ne projektin perkates. Mbulesat e palestres dhe strehes se verandes jane me sanduic 4 cm.

7.2 Analiza Dinamike e Struktures

Per te pasqyruar sa me sakte karakteristikat dinamike te struktureve jane marre ne konsiderate 9 forma baze lekundjesh. Kjo ka sjelle si rezultat perfshirjen ne lekundje te pothuajse rreth 99 % te mases se godines. Perioda e tonit te pare te lekundjeve ka rezultuar $T=1.203$ sek.

Bashkia „Elbasan“


Rikonstruksioni i shkoles „Jorgji DILO“

Tabela e periodave dhe rezultateve te analizes dinamike


Modal Shape Table:

Shape	Ω (rad/sec)	T (sec)	S_d	Ψ_x	C_x (%)	Ψ_y	C_y (%)	Ψ_z	C_z (%)
1	9.84	0.638	2.04	38.69	63.98	-8.25	2.91	0.13	0.00
2	10.71	0.587	2.22	6.64	1.88	35.72	54.52	0.01	0.00
3	11.34	0.554	2.35	-10.40	4.62	-26.01	28.91	-0.08	0.00
4	13.32	0.472	2.61	-19.31	15.93	9.97	4.24	-0.02	0.00
5	14.68	0.428	2.61	5.54	1.31	-0.07	0.00	0.24	0.01
6	17.14	0.367	2.61	0.26	0.00	0.09	0.00	-0.01	0.00
7	23.08	0.272	2.61	1.11	0.05	0.24	0.00	0.08	0.00
8	28.06	0.224	2.61	2.45	0.26	-0.21	0.00	0.01	0.00
9	29.40	0.214	2.61	11.47	5.63	1.04	0.05	-0.10	0.00
10	30.05	0.209	2.61	-2.51	0.27	2.13	0.19	0.03	0.00
11	32.11	0.196	2.61	-0.09	0.00	-13.43	7.71	0.01	0.00
12	34.22	0.184	2.61	0.24	0.00	-0.73	0.02	0.03	0.00
13	36.18	0.174	2.61	4.38	0.82	-0.04	0.00	-0.03	0.00
14	36.73	0.171	2.61	7.66	2.51	-0.52	0.01	-0.06	0.00
SUM					97.26		98.58		

Shperndarja e Shpejtimeve dhe Forcave Sizmike sipas Drejtimit X




Shperndarja e Shpejtimeve dhe Forcave Sizmike sipas Drejtimit Y



Format modale te lekundjes se objektit :


Lekundja sipas Tonit te Pare T= 0.638 sec, $\Omega = 9.84$ (rad/sec):




Bashkia „Elbasan“

Rikonstruksioni i shkoles „Jorgji DILO“


Lekundja sipas Tonit te Dyte $T= 0.587\text{sec}$, $\Omega = 10.71 \text{ (rad/sec)}$:



Lekundja sipas Tonit te Trete $T= 0.554 \text{ sec}$, $\Omega = 11.34 \text{ (rad/sec)}$:



Lekundja sipas Tonit te Katert $T= 0.472$ sec, $\Omega = 13.32$ (rad/sec):




8. THEMELET



Bazuar ne reportin e studimit gjeologjik te sheshit ku do ndertohej objekti si edhe ne teorine e Terzaghit, me shprehjen Meyerhoff, eshte bere llogaritja e aftesise mbajtese te tokes. Sforcimet qe lindin nen tabanin e themelit jane nen vleren e sforcimeve te lejuara. Tabani i themelit mbeshtetet ne **Shtresen Nr.2** e cila perfaqesohet nga suargjila deri ne argjila me ngjyre bezhe. Jane me pak lageshti, te ngjeshura dhe shume te konsoliduara dhe kane perzierje materiali zhavorror kokerr imet dhe me zaje te rralla kokerr vogel me perberje kryesisht ranori e me rralle gelqerorir. Dimensionet e themelit ne plan jane zgjedhur te tilla qe te arrihet nje shperndarje sforcimesh ne tabanin e themelit, brenda vlerave te lejuara.

GROUND PARAMETERS				
Permissible Stress:	1.80	MPa	Ground Coeff:	100.00 N/cm ³

Te dhenat e truallit



9. REZULTATET

Mbi bazen e rezultateve te dimensionimit te elementeve eshte bere edhe armimi i tyre si dhe detajimi i sejclilit element ne vecanti.

Me poshte jane paraqitur ne menyre te detauar nje pjese e llogaritjeve kompjuterike, te cilat perfshijnë llogaritjen e soletave, trareve dhe kolonave te disa kateve te objektit.

Nderhyrjet per rikonstruksionin e objektit egzistue nuk prekin strukturan mbajtese te objektit.

KONKLUZION

Objekti „Rikonstruksion objekti egzistues + Shtese anesore 3 kat + 1 kat palester“ eshte i qendrueshem nga ana statike dhe dinamike.

PROJEKTUESI I OBJEKT

Ing. Konst. Reshit BEDHIA

Nr.Lic. K 0305/2

Elbasan, Shkurt 2019